



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Regulatory Authority of Electronic and Postal Communications
Regulatorni Autoritet za Elektronske i Poštanske Komunikacije

Datë: 17/07/2013

PËRGJIGJET (KONKLuzionet) E AUTORITETIT
LIDHUR ME KOMENTET E PRANUAR GJATË FAZËS SË
KËSHILLIMIT PUBLIK TË DOKUMENTIT

**'Rregullorja Teknike për radio pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese dhe
kompatibilitetit elektromagnetik (Njohja e Konformitetit)'**

Bordi i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP*) në mbledhjen e datës 12 Qershor 2012, sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Brendshme të ARKEP, dhe në përputhje me detyrimet e specifikuar në Ligjin e Telekomunikacionit Nr.2002/7 (tashmë të shfuqizuar me Ligjin për Komunikimet Elektronike Nr.03/L-109, *tutje referuar si - Ligji ose LKE*), mori në shqyrtim dhe miratoi (*Ref. Vendimi Nr. 219 ARKEP Nr.Prot. 040/B/12*), fillimin e procesit të këshillimit publik të dokumentit: **Draft Rregullore për vlerësimin e konformitetit, shpërndarjes dhe shfrytëzimit të radio pajisjeve dhe pajisjeve terminale të rrjetit të komunikimeve elektronike.**

Këshillimi publik i dokumentit të referuar si më lartë ka zgjatur nga data; **22 Qershor 2012** deri me datën; **23 Korrik 2012**, i cili dokument gjithashtu është publikuar në ueb faqen zyrtare të ARKEP-it, përkatësisht në linkun: <http://www.art-ks.org/?cid=1,13>

Sa i përket këshillimit publik, komente ka paraqitur vetëm operatori, IPKO Telecommunications LLC (*Ref; Shkresa/e-maili e datës: 23 Korrik 2012, 3:42 PM*). Pas shqyrtimit të komenteve të prezantuara nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), si dhe harmonizimit të draft rregullores me LKE, nënkuptuar këtu optimizimin e saj dhe eliminimin e pjesëve të pa-nevojshme, të cilat janë konstatuar si të tilla nga njësitë funksionale brenda ARKEP, Bordi i ARKEP në mbledhjen e L) të mbajtur me datë; 4 Korrik 2013, me vendimin Nr.380 (*Ref. ARKEP Nr.Prot.024/B/13*) miratoi dokumentin final **'Reg. Nr. 19 - Rregullore teknike për radio pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese dhe kompatibilitetit elektromagnetik (Njohja e Konformitetit)'**.

Në tabelën në vijim janë dhënë komentet e dërguara nga operatori IPKO si dhe përgjigjet/qëndrimet e ARKEP ndaj këtyre komenteve.

Tabela 1: Komentet e ndërmarrjes IPKO LLC

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO	Përgjigja e ARKEP-it
1.	<p>1.1.5 Fuqia e radio frekuences:</p> <p>Deri në 8 W (39 dBm)/ Klasa 2 Deri në 5 W (37 dBm)/ Klasa 3 Deri në 2 W (33 dBm)/ Klasa 4 Deri në 0.8 W (29 dBm)/Klasa 5</p>	<p>II. Parametrat e “Llojit 1” Radio dhe/ose Pajisje Terminale, që gjithashtu është menduar për Transmetim të Radio Valëve</p> <p>1. GSM pajisje terminale:</p> <p>1.1. GSM900 dhe GSM-R (Nënklasë(Nëntip) 9) Faqe 30 nga 44</p> <p><u>Koment 1:</u></p> <p>1.1.5 Fuqia e radio Frekuencës Meqenëse një pjese e Kosovës është terren malor,IPKO propozon qe te parashihen standarde te cilat lejojnë nivel me te larte te fuqisë se radio frekuencës.</p>	<p>Vlerat e përcaktuara në draft rregullore janë ne harmoni te plot me specifikimet teknike te ETSI - GSM 05.05. Në përgjithësi, të gjitha standardet GSM janë plotësisht të harmonizuara në vendet e BE dhe nuk ka ndonjë ndonjë përjashtim.</p> <p>Sqarim; Klasat e paraqitura në draft rregullore kanë të bëjnë me Mobile Station (MS) - Pajisje Mobile e jo me Base Transiver Station (BTS) - Stacion Transmetues Bazë. Në vazhdim janë sqaruar klasat dhe pajisjet që mund të përdorën. Klasa 2 mund të përdoret vetëm në ‘Portable and Vehicle’ e jo pajisje mobile të dorës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klasa 2 8 W Portale and Vehicle • Klasa 3 5 W Hand-held (Pajisje mobile e dorës) • Klasa 4 2 W Hand-held (Pajisje mobile e dorës) • Klasa 5 0.8 W Hand-held (Pajisje mobile e dorës) <p><u>Komenti nuk pranohet.</u></p>
2.	N/A	<p><u>Koment 2</u></p> <p>1.1.6. Fuqia rrezatuese e radio frekuencës (RF)</p> <p>A do te caktohet niveli i fuqisë rrezatuese të radio frekuencës meqenëse ekzistojnë standarde për këtë (Amendment Directive 2004/40/CE, Recommendations 1999/512/EC, 1999/519/EC). Nga kjo do të varej edhe niveli i fuqisë së radio frekuencës.</p>	<p>Fuqia rrezatuaes e radio frekuences nuk eshte specifikuar, pasi qe nje specifikim i tillë nuk eshte bere as në Planin Kombatar te Radio Frekuencave. Sidoqoftë, ARKEP ka marr parasysh komentin dhe teksti eshte ndryshuar si ne vijim: <u>“Në përputhje me Direktiven 2004/40/EC dhe Rekomandimin, 1999/519/EC”</u></p> <p><u>Komenti pranohet.</u></p>

Përgatitur nga:

- Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE),
- Departamenti i Menaxhimit të Frekuencave (DMF),
- Departamenti i Radio Monitorimit dhe Inspektimit (DRMI), dhe Departamenti Ligjor (DL)